AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

# NJOFTIM PËR KONTRATË

## *SHËRBIME*

*Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 04/05/2016**

| **Nr i Prokurimit** | **239** | **16** | **017** | **211** |
|---|---|---|---|---|

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) | | |
| **Adresa Postare**: Rr.Agim Ramadani nr.23 | | |
| Qyteti: Prishtinë | Kodi postar:10000 | Vendi: Republika e Kosovës |
| **Personi kontaktues**: Merita Zekaj dhe Marjan Perlaska | | Telefoni: 500 400 – lokali 1049,1107 |
| Email: merita.zekaj@pak-ks.org marjan.perlaska@pak-ks.org | | Faksi: 038 248 074 |
| Adresa e Internetit: | | www.pak-ks.org |

Kontrata përfshinë prokurimin e përbashkët — Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit — Po ☐ Jo ☒

| |
|---|
| ***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi. |

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**

**"Kontraktimi i Kompanisë për ofrim të shërbimit profesional për realizim të Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj"**

| **II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit** | | |
|---|---|---|
| ☐ **Punë** | ☐ **Furnizime** | ☒ **Shërbime** |
| ☐ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | Kontraktimi i Kompanisë për ofrim të shërbimit profesional për realizim të Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj |
| Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve<br>___________________________<br>______________________ | Vendi kryesor i dorëzimit<br>________________________<br>________________________ | Vendi kryesor i realizimit<br><br>Selia e AKP-se,Njësia për Riorganizimin e Trepçës AKP |

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë **Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë***:N/A*

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**

Kontraktimi i një kompanie për ofrim të shërbimit profesionale për realizimin e Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj qe do te përfshin:

1. **<u>Përshkrim i shkurtër për ndërmarrjen Trepça</u>**
2. **<u>Administrimi i ndërmarrjes Trepça</u>**
3. **<u>Statusi aktual i ndërmarrjes Trepça</u>**
4. **<u>Planifikimi për angazhimin e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për realizim të studimit të Fizibilitetit,</u>**
5. **<u>Shërbimet e kërkuara nga Administratori</u>**

- **FIZIBILITETI I AKTIVITETEVE THEMELORE TË TREPÇËS**
- **ORIENTIMI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E TREPÇËS ME FOKUS NË PROCESIMIN E METALEVE DHE NË AKTIVITETET ME VLERË TË SHTUAR TË LARTË,**
- **KONKLUDIME DHE REKOMANDIME**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):93**

**II.1.7) Variantet pranohen** **Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë** **Po** ☐ **Jo** ☒

**II.I.9) Ne rast te një apo me shume pjesëve:N/A**

**II.1.10) Informacione lidhur me pjesët :N/A**

**II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: 1.300,000.00 € (Një milion e treqind mije euro).**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm:**

1. **<u>Përshkrim i shkurtër për ndërmarrjen Trepça</u>**

   "Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP" është grup i entiteteve me lokacion kryesisht në regjionin e Mitrovicës në Kosovë, por gjithashtu me me asete dhe degë që shtrihen në regjionet e ndryshme në Kosovë. Në të kaluarën ka qenë një nga ndërmarrjet më të mëdha në Kosovë me mbi 20,000 të punësuar gjatë një periudhe. "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP" ka tre komponente kryesore: I) Minierat dhe Flotacionet; II) Parkun Industrial në Mitrovicë ; III) Kompleksin e Shkritores në Zveçan. Për më tepër, ka edhe aktivitete tjera që rrjedhin nga të lartëpërmendurat që shfrytëzojnë plumbin, zinku, argjendin, etj, në përpunim final te këtyre dhe lëndëve të tjera. Biznesin kryesor të Trepçës, aktualisht e përbëjnë katër miniera aktive: Stantërgu, Artana, Belo Berdo dhe Cernac, si dhe tri flotacione cilat operojnë, e të cilat janë: Tuneli i Parë, Kishnica dhe Leposavic.

2. **<u>Administrimi i ndërmarrjes Trepça</u>**

   Për shkak se ndërmarrja nga vitit 1999, nuk ka arritur të operojë në kushte komerciale tërësisht pozitive dhe për të ruajtur asetet e Ndërmarrjes kundër kërkesave dhe pretendimeve të kreditorëve dhe përpjekjeve për materializimin e kërkesave të tilla, në vitin 2006 AKM-ja kërkoi nga DHPGJS të vendos Ndërmarrjen në moratorium, e cila kërkesë u miratua më 8 Mars 2006. Sot, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Riorganizim, AKP-ja ushtron mandatin e saj si Administrator i Ndërmarrjes.

3. **<u>Statusi aktual i ndërmarrjes Trepça</u>**

   Ndërmarrje aktualisht është nën masën e moratoriumit. Me qëllim të zgjidhjes të problemeve të ndërmarrjeve të veçanta, si rasti i ndërmarrjes Trepça, ligjvënësi ka nxjerr Ligjin për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurive të Tyre nr. 04/L-035; dhe ligji për amandamentim 05/-L-008. Me këtë Ligj Agjencia Kosovare e Privatizimit është përcaktuar administratore e NSh "Trepça". Fushëveprimi i këtij ligji bie mbi ndërmarrjen Trepça, dhe si i tillë ligji ka paraparë procedura strikte të përcaktuara në afate ligjore që Administratori duhet ti ndërmerr me qëllim të rivitalizimit të ndërmarrjes Trepça, përderisa në rast të kundërt Ligji parasheh edhe likuidimin e ndërmarrjes.

4. **<u>Planifikimi për angazhimin e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për realizim të studimit të Fizibilitetit</u>**

   Me synim të përmbushjes së suksesshme të mandatit të Administratorit AKP, në përputhje me nenin 7.2 të ligjit për riorganizim planifikon të angazhoj kompani të specializuar në mbështetje të aktiviteteve të Administratorit gjatë procesit të riorganizimit të kësaj ndërmarrje. Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka miratuar kërkesën e menaxhmentit të AKP-së për fillimin e procedurave për përgatitjen e tenderit për angazhimin e një kompanie për ofrim të shërbimit profesionale për realizimin e Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj

5. **<u>Shërbimet e kërkuara nga Administratori</u>**

- **FIZIBILITETI I AKTIVITETEVE THEMELORE TË TREPÇËS, duke u bazuar në**
  - Analizën e tregut,
  - Aspektet teknologjike dhe burimet njerëzore duke analizuar në mënyrë specifike
    - Lëndën e parë dhe furnizimet
    - Inxhinieringun dhe teknologjinë
    - Planin e burimeve njerëzore për reorganizimin e Trepçës.
  - Ristrukturimin dhe menaxhimin - duke përfshirë:
    - shqyrtim i legjislacionit aktual lidhur me aktivitetet e Trepçës
    - Alternativat për strukturën e pronësisë
    - Organizimi dhe shpenzimet e përgjithshme
  - Analizë të plotë dhe reale të pozitës/vendndodhjeve dhe ndikimeve mjedisore
  - Implementimi i projektit
  - Analiza financiare dhe vlerësimi i investimit

- **ORIENTIMI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E TREPÇËS ME FOKUS NË PROCESIMIN E METALEVE DHE NË AKTIVITETET ME VLERË TË SHTUAR TË LARTË,** bazuar në analizat që identifikojnë:
  - Prodhimet dhe shërbimet e mundshme me vlerë të shtuar më të lartë;
  - Tregjet potencialepër produktet me vlerë të shtuar më të lartë;
  - Nevojat teknologjike
  - Volumin e investimeve
  - Nevojat për burime njerëzore dhe trajnime;
  - Treguesit (e përkohshëm) financiar dhe investues;
  - Si dhe çdo aspekt tjetër relevant që duhet marrë parasysh gjatë orientimit strategjik.

- **KONKLUDIME DHE REKOMANDIME** lidhjur me gjetjet kryesore të studimit duke dhënë:
  - Matricë të alternativave bazuar në analizën me përfitim në kosto lidhur me prodhimet aktuale, por edhe të produkteve me vlerë të shtuar më të lartë
  - Rekomandime për tregjet aktuale dhe për orientime kah tregjet potenciale,
  - Rekomandime për zgjedhjet optimale teknologjike
  - Rekomandime për struktura optimale e pronësisë
  - Rekomandime për nevojat për investime, mënyrat duke bazuar në qasjet e mundshme për investime, duke u nisur nga shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve,
  - Rekomandime për ndryshimet ligjore, të nevojshme
  - Si dhe rekomandime relevante që duhet marrë parasysh në vendimmarrjen për krijimin e kushteve dhe potencialeve për afarizëm të qëndrueshëm të ndërmarrjes Trepça.

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj:**4 muaj** nga nënshkrimi i kontratës

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

## III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit** **Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit: **10% e vlerës së kontratës** ne afatin prej **5 muajsh**

| |
|---|
| **III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata**:N/A |
| **III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës** **Po** ☐ **Jo** ☒ |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

**III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**
**Kërkesa dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat e specifikuara në nenin 65 te Ligjit të Prokurimit Publik (LPP),Ligji nr 04/L-42 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
   LPP mund të shkarkohet në adresen:Krpp.rks-gov.net
2. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për Dhënie te Kontratës
3. Vërtetimin nga Gjykata së OE nuk është shpallur fajtor në përputhje me nenin 65 te LPP.

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

1. Një deklaratë e shkruar nën Betime nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit.
2. Të dëshmohet me vërtetimin e ATK-së,
3. Vërtetimi i Gjykatës.

Dokumentet nën 2 dhe 3 duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzimin e dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

**III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**
**Kërkesa dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

1. Certifikata e regjistrimit te biznesit, së bashku me përshkrimin e veprimtarive primare dhe sekondare të kompanisë.
2. Certifikata e regjistrimit për TVSH
3. Certifikata e regjistrimit për Numër Fiskal

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

1. Kopja e certifikatës
2. Kopja e certifikatës
3. Kopja e certifikatës

**III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**Kërkesa**

1 Tenderuesi duhet të ketë qarkullim të përgjithshëm prej 2.000,000.00 € (dy milion euro) kumulativ për tri vitet e fundit: (2013, 2014 dhe 2015).

2 Tenderuesi duhet të ketë së paku dy projekte të studimeve të fizibilitetit ne fushën e riorganizimit dhe ristrukturimit të së paku dy ndërmarrjeve individuale të profilizuara në industrinë e minierave dhe metaleve gjatë 10 viteve të fundit.

| |
|---|
| **Dëshmia e kërkuar dokumentare:**<br><br>1. Te dëshmohen me raporte bankare ose pasqyra financiare te publikuara;<br>2. Te dëshmohet me listën e kontratave paraprake duke saktësuar shërbimet e realizuara lidhur me studimin e fizibilitetit në fushën e riorganizimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve, shumën e kontratave dhe datën e kontratës. |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional**<br>**Kërkesat:**<br>1. Menaxheri i projektit duhet të ketë minimum 5 vjet përvojë në menaxhimin e projekteve të studimit te fizibilitetit në riorganizim, ristrukturim dhe rivitalizim të ndërmarrjeve në fushën e industrisë se minierave dhe metaleve.<br>2. Kapaciteti profesional së paku:<br>a) një ekspert hulumtues apo analist i tregut,<br>b) një ekspert në fushën e logjistikes dhe menaxhimit të stoqeve<br>c) një ekspert në fushën e inxhinierisë dhe teknologjisë së përpunimit,<br>d) një ekspert në fushën e burimeve njerëzore dhe aspekteve sociale,<br>e) një ekspert ligjor për ceshtje komerciale;<br>f) një ekspert ligjor në fushën e pronësisë,<br>g) një ekspert në fushën e trajtimit mjedisor dhe ambiental;<br>i) dy ekspertë për analizë financiare të ndërmarrjeve/vlerësime të investimeve;<br><br>**Dëshmia e kërkuar dokumentare**<br>1. Te dëshmohen me CV ose me kontrata ose me referenca;<br>2. Nen **a,b,c,d,e,f,g,i** të dëshmohet eksperienca ne fushat adekuate me CV ose me kontrata ose me referenca. |

**III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar** | **Po** | ☐ | **Jo** | ☒ |
| **III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve** | **Po** | ☐ | **Jo** | ☒ |

**NENI IV: PROCEDURA**

**IV.1) LLOJI I PROCEDURËS**

| |
|---|
| **IV.1.1) Lloji i procedurës** |
| ☒ **E hapur** |
| **IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim:N/A** |
| **IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave:N/A** |
| **IV.1.4) Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë:N/A** |

**IV.2) KRITERET E DHËNIES**

| |
|---|
| ☒ **Çmimi më i ulët** |

**IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE**

| | |
|---|---|
| **IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë** | **Po** ☐ **Jo** ☒ |
| **IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit**<br><br>Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit **30/05/2016** | |
| Dokumentet me pages **Po** ☐ **Jo** ☒ | |
| **IV.3.3) Afati i fundit për pranim të tenderëve:**<br><br>**Data:15/06/2016** ; **koha:14:00 h;adresa:AKP rr.Agim Ramadani nr.23 zyra nr 52a Prishtinë** | |
| **IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar:**<br>☐ po ☒ jo | |
| **IV.3.5)** A është e nevojshme siguria e tenderit:<br><br>***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit:**39,000.00 €**<br>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë:**120 ditë** | **Po** ☒ **Jo** ☐ |
| **IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: 90 ditë** | |
| **IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:**<br><br>**Data:15/06/2016; koha:14:30 h; adresa:AKP rr.Agim Ramadani nr.23; zyra nr 52a Prishtinë** | |

**NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE**

**V.1) ANKESAT**

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.**

**V.2) INFORMACIONET SHTESË**

**Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**

**Vizita ne punishte: Te mërkurën me 25 maj 2016.**
**Takimi ne AKP ne ora 10;00h**